UNIVERSITETI I MITROVICËS "ISA BOLETINI"

FAKULTETI I EDUKIMIT

PUNIM DIPLOME

Lendita Basholli

Mitrovicë, 2020

UNIVERSITETI I MITROVICËS "ISA BOLETINI"

FAKULTETI I EDUKIMIT

PUNIM DIPLOME

Zbatimi i kurrikulës te Shkencat e natyrës në shkollat fillore të Vushtrrisë

Mentori: Kandidatja:

Prof.Dr. Qerim Selimi Lendita Basholli

Mitrovicë, 2020

UNIVERSITETI I MITROVICËS "ISA BOLETINI"

FAKULTETI I EDUKIMIT

PROGRAMI Fillor

PUNIM DIPLOME

Lënda: Bazat e shkencave natyrore me metodologjin II

Titulli i punimit: Zbatimi i kurrikulës te Shkencat e natyrës në shkollat fillore të Vushtrrisë

Emri dhe mbiemri: Lendita Basholli

Statusi i studentit: i rregullt

Numri i amzës (ID regjistri) 1606011085

Niveli i studimeve: Bachelor

Programi i studimit: Fillor

Mentori/ja i/e punimit: Prof.dr. _ Prof.Dr. Qerim Selimi

Aprovuar prej komisionit:

1. _____, mentor

/Emri, mbiemri,titulli /

2. _____, anëtar

/Emri, mbiemri,titulli /

3. _____, anëtar

/Emri, mbiemri,titulli /

Data e aprovimit:_____

DEKLARATË

Unë, Lendita Basholli, studente në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini” në Fakultetin e Edukimit, deklaroj se punimi i kësaj diplome me titull “Zbatimi i kurrikulës te Shkencat e natyrës në shkollat fillore të Vushtrrisë”, është rezultat i punës sime dhe është punuar përsonalisht nga unë. Rregullat e punës i kam respektuar sipas rregullores së Fakultetit të Edukimit.

Deklaroj se të gjitha fjalitë dhe idetë e cituara në këtë punim, marrë nga autorët e tjerë, janë përdorur dhe vendosur në listen e referencave, sipas stilit të APA-s.

PËRMBAJTJA

Lista e tabelave 6
Lista e grafikave 6
Lista e shkurtesave 7
ABSTRAKTI 8
ABSTRACT 9
HYRJE 10
1.1 Korniza Kurrikulare 12
1.2 Zbatimi i kurrikulës 14
1.3 Planprogrami 17
1.4 Shkencat e natyrës 19
1.5 Zbatimi I kurrikulës te shkencat e natyrës. 20
2.METODOLOGJIA 23
2.1 Dizajni i hulumtimit 23
2.1 Pjesëmarrësit 23
2.2 Instrumentet 24
2.3 Mënyra e mbledhjes së të dhënave 24
2.4 Analizat, ... 25
2.5 Aspekti etik, ... 25
3.REZULTATE 26
3.1 Vërtetimi I hipotezave 34
4. DISKUTIMET 37
5.KONKLUDIME DHE REKOMANDIME 39
LITERATURA 40
AUTOBIOGRAFIA 46

Lista e tabelave

Tabela 1. *Te dhënat demografike për pjesëmarrësit, gjinia, vendbanimi, niveli arsimor, mosha dhe përvoja si mësimdhënës……26*

Tabela 2. *Paraqitja tabelare sesa janë të informuar mësimdhënësit për mundësitë dhe kërkesat e kurrikulës.....27*

Tabela 3.*Paraqitja tabelare sesa është e përshtatshme kurrikula për zbatim……..28*

Tabela 4.*Paraqitja tabelare se a janë të arritshme rezultatet për kompetenca kryesore…….28*

Tabela 5.*Paraqitja tabelare se a ka ndryshuar planifikimi për orë mësimore……..…29*
Tabela 6.*Paraqitja tabelare se a janë në harmoni planet ditore me ato vjetore…….30*
Tabela 7.*Paraqitja tabelare se a ju ndihmon KKK-ja në planifikim…….30*
Tabela 8.*Paraqitja tabelare se a janë të mjaftueshëm trajnimet që kanë ndjekur për zbatimin e kurrikulës……31*
Tabela 9.*Paraqitja tabelare se a zbatohet plani për orë mësimore……32*
Tabela 10.*Paraqitja tabelare se a bashkëpunojnë me kolegët për të zgjidhur vështirësitë gjatë zbatimit të kurrikulës……32*
Tabela 11.*Paraqitja tabelare se a bashkëpunojnë me kolegët për të zgjidhur vështirësitë gjatë zbatimit të kurrikulës……33*
Tabela 12.*Paraqitja tabelare se a bashkëpunojnë me kolegët për të zgjidhur vështirësitë gjatë zbatimit të kurrikulës……33*
Tabela 13. *Vërtetimi i hipotezës përmes korrelacionit……34*
Tabela 13.1. *Vërtetimi i hipotezës përmes korrelacionit……35*

Lista e grafikave

Grafiku 1: *Paraqitja në formë grafike e pyetjes së gjashtë.....27*
Grafiku 2*: Paraqitja në formë grafike e pyetjes së shtatë…….……28*
Grafiku 3*: Paraqitja në formë grafike e pyetjes së tetë…….……29*
Grafiku 4*: Paraqitja në formë grafike e pyetjes së nëntë…….……29*
Grafiku 5*: Paraqitja në formë grafike e pyetjes së dhjetë…….……30*
Grafiku 6*: Paraqitja në formë grafike e pyetjes së njëmbëdhjetë…….……..31*
Grafiku 7*: Paraqitja në formë grafike e pyetjes së dymbëdhjetë…….……31*
Grafiku 8: *Paraqitja në formë grafike e pyetjes së trembëdhjetë……33*
Grafiku 9:*Paraqitja në formë grafike e pyetjes së katërmbëdhjetë……34*
Grafiku 10: *Paraqitja në formë grafike e pyetjes së pesëmbëdhjetë……..34*
Grafiku 11: *Paraqitja në formë grafike e pyetjes së gjashtëmbëdhjetë……35*

Lista e shkurtesave

KK	Korniza Kurrikulare
KKK	Korniza Kurrikulare e Kosovës
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Tekonologjisë
RNSH	Rezultatet e të nxënit për shkallë
RNF	Rezultatet e të nxënit të fushave kurrikulare

ABSTRAKTI

Ky punim diplome bachelor paraqet pikëpamjen e mësimdhënësve në zbatimin e kurrikulës nga klasa e parë deri në klasën e pestë në kumunën e Vushtrrisë. Zbatimi i kurrikulës ka një rëndësi të madhe në të nxënit e një nxënësi, dhe gjithashtu jep sqarime dhe lehtësim të punës së mësimdhënësit duke i ndihmuar për shpjegimin dhe sqarimin e temave të ndryshme.Qëllimi i këtij hulumtimi është të kuptojmë sesa zbatohet kurrikula në Shkencat e Natyrës në shkollat fillore, nga klasa e parë deri në klasën e pestë, nga ana e mësimdhënësve.

Për metodologjinë e punimit është përdorur metoda sasiore\ kuantitative. Mënyra e mbledhjes së të dhënave ishte me anë të pyetësorit. Në këtë punim u testuan katër shkolla nga Vushtrria; dy shkolla nga fshatrat e Vushtrrisë : "Lumni Surdulli" e Samadrexhës, "Rilindja" e Maxhunajt; dy shkolla nga qyteti: " Naim Frashëri" dhe " Mustafë Venhari". Gjithsej morën pjesë 20 mësimdhënës. Atyre, pyetësori u është dorëzuar në mënyrë elektronike, për shkak të situatës që gjendemi me pandeminë Covid-19. Prej secilës shkollë morën pjesë nga 5 mësimdhënës. Pastaj në bazë të tyre kemi arritur t'i nxjerrim rezultatet e nevojshme që tregojnë për përfshirjen e mësimdhënësve në zbatimin e kurrikulës. Nga të dhënat në tabela, konstatojmë që 55 % e pjesëmarrësve pajtohen me deklaratën: "Sa jeni të informuar për mundësitë dhe kërkesat e Kurrikulës në Shkencat e Natyrës?"; 20% pajtohen tërësisht, ndërkohë që 15% e tyre nuk pajtohen dhe 10% e tyre deklarojnë që nuk e dinë. Nga pyetja në lidhje me deklaratën: "Kurrikula në Shkencat e Natyrës, a është e përshtatshme për zbatim?" ; 70% e pjesëmarrësve deklarojnë që pajtohen, ndërkohë 15% e pjesëmarrësve kanë deklaruar se nuk e dinë; 10% e tyre pajtohen me pyetjen dhe vetëm 5% e nga ata, deklaruan që pajtohen tërësisht. Në lidhje me pyetjen:"Në përgjithësi, a keni gatishmëri ta zbatoni Kurrikulën në shkencat e natyrës?". Nga deklaratat e dhëna, vihet re se në mënyrë të barabartë 45% e pjesëmarrësve kanë thënë që pajtohen plotësisht dhe 45% pajtohen, ndërkohë që 5% nuk e dinë dhe 5% nuk pajtohen.

Fjalët kyçe: zbatim, kurrikulë, mesimdhënie, nxënie

ABSTRACT

This bachelor thesis presents the view of teachers in the implementation of the curriculum from the first to the fifth grade in the municipality of Vushtrri. Curriculum implementation is of great importance in a student's learning, and also provides clarification and facilitation of the teacher's work helping them to explain and clarify various topics. The purpose of this research is to understand how much the curriculum in Natural Sciences is implemented in the primary schools from the first grade to the fifth grade, by the teachers.

Quantitative method was used for the working methodology. The way of data collection was through the questionnaire. In this paper were tested four schools from Vushtrri, two schools from the villages of Vushtrri: "Lumni Surdulli" -Samadrexhë, "Rilindja" -Maxhunaj, and two schools from the city: "Naim Frashër", "Mustaf Venhari", a total of 20 participated teachers to whom the questionnaire was delivered electronically due to the situation we are in with the COVID-19 pandemic. From each school participated 5 teachers, then based on them we managed to extract the necessary results that shoë the involvement of teachers in the implementation of the curriculum. From the data in the table we see that 55% of participants agree with the statement "How much are you informed about the opportunities and requirements of the Curriculum in Natural Sciences?", 20% completely agree, while 15% of them disagree and 10% of them declare that they don’t know. From the question regarding the statement "Curriculum in Natural Sciences is suitable for implementation." 70% of participants state that they agree while 15% of participants stated I do not know, 10% agree with the question and only 5% of them stated that they completely agree. Regarding the question “In general, are you willing to apply the Curriculum in natural sciences” the statement given is noticed that equally 45% of the participants have stated completely agree and 45% agree ëhile 5% do not know and 5 % do not agree.

Keywords: Implementation, curriculum, teaching, learning

HYRJE

Mësimdhënësit e sotëm kanë nevojë të ndryshojnë. Ata kanë nevojë për ndihmë që të bëhen ata që duhet të jenë: herë vështgues, herë planifikues dhe përgatitës të mësimit dhe të aftësimit për të punuar, vlerësues të njohurive të përfituara nga nxënësit, menaxhues të klasës, kërkues shkencorë në punën e tyre si dhe model i një personi pozitiv (Alimehmeti M & Leonard D,2012).

Për realizimin e përmbajtjes së lëndës Njeriu dhe natyra, qoftë të aktiviteteve kurrikulare dhe jashtëkurrikulare, në arritjen e kompetencave, mësimdhënësi përzgjedhë metodat, teknikat dhe format e nevojshme në përshtatje me nevojat dhe mundësitë e nxënësve në linjë me realizimin e rezultateve të pritshme në kontekst të filozofisë dhe parimeve të Kornizës së Korrikulës (MASHT, 2018).

Kurrikula e re promovon qasje të bazuara në aftësi, të cilat zhvillohen përmes mësimit që bazohet në punën praktike. Qëllimi është për përfitimet e mundshme nga numri gjithnjë në rritje i të rinjve të arsimuar të përdoren më së miri që të përmirësohet shoqëria, ekonomia dhe mjedisi kosovar, për ta sjellë Kosovën më pranë shoqërive më të përparuara evropiane. Në këtë kontekst, një nga 6 qëllimet e arsimit parauniversitar sipas kurrikulës së re është: zhvillimi i përgjegjësive ndaj vetes, të tjerëve dhe mjedisit. Kështu që qëllimi kryesor është që të mbështeten studentët, të zhvillojnë përgjegjësitë ndaj tyre, të tjerëve dhe mjedisit, në kontekstin e ndërgjegjësimit që rritet për pasojat e veprimeve personale (Veselaj & Krasniqi, 2014).

Korniza Kurrikulare e Kosovës(KKK) përbëhet nga tërësi dokumentesh dhe masash të përcaktuara për zbatimin e saj. Këto dokumente ndahen në dy pjesë kryesore:

- pjesën konceptuale, që është vetë Korniza Kurrikulare dhe;
- pjesën e zbatimit, që e përbëjnë dokumentet shoqërore, të cilat mundësojnë zbatimin e KKK-së në nivel të sistemit arsimor duke përcaktuar qartë pritshmëritë nga nxënësi, nga mësimdhënësi dhe nga shkolla.

Me Kornizën Kurrikulare, MASHT-i është përcaktuar për një qasje të bazuar në kompetenca, respektivisht qasje të orientuar kah rezultatet e pritura që duhet të arrihen nga të gjithë nxënësit në periudha të ndryshme të shkollimit. Qasja e bazuar në kompetenca zhvendos përqëndrimin nga presioni për realizimin e përmbajtjes së përcaktuar me planprograme dhe tekste shkollore, në zhvillimin e kompetencave të përcaktuara në kuadër të kurrikulës. Siç është përshkruar edhe në

Udhëzuesin për udhëheqjen e shkollës në zbatimin e kurrikulës, parimet e përcaktuara me Kornizën Kurrikulare, sigurojnë koherencën e procesit të zbatimit të qasjes së bazuar në kompetenca. Prandaj duhet të trajtohen në mënyrë tërësore duke pasur parasysh relacionin e ndërvarësisë mes tyre. Shkallët kurrikulare, sipas të cilave strukturohet sistemi i kurrikulës, paraqesin pikën referuese për përcaktimin e kompetencave kryesore që duhen zotëruar nga të gjithë nxënësit, kërkesat e progresit të nxënies, organizimin e përvojave mësimore, qasjen dhe kriteret e vlerësimit (KEEN, 2018).

Plani i orës mësimore shërben që të gjitha planifikimet e procesit mësimor të bëhen të zbatueshme në punën e drejtpërdrejtë me nxënës në klasë dhe jashtë saj, brenda një ore mësimore. Në këtë planifikim mësimdhënësi/ja përcakton:

- njësinë mësimore të cilën do ta realizojë (njësia mësimore merret nga planifikimi dymujor, përkatësisht planifikimi javor) ;
- rezultatet e synuara të kompetencave (të cilat i ka përcaktuar në planifikimin dymujor të temës mësimore) ;
- rezultatet e synuara të fushës kurrikulare (mund të vendosen vetëm rezultatet e lëndës mësimore që korrespondojnë me rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare, Shkencat e natyrës, edhe këto merren nga planifikimi dymujor) ;
- kriteret e suksesit, të cilat duhet të caktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës (Kastrati, R & Avdylaj, M. 2014).

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është përgjegjëse për hartimin e standardeve për sigurimin e cilësisë dhe krijimin e mekanizmave për zbatimin e zhvillimit profesional të mësimdhënësve. Në formularin e aplikimit për programe të trajnimit për mësimdhënësit dhe punëtorët arsimorë, të përgatitur nga MASHT-i, janë përcaktuar dy kërkesa për ofruesit e programeve të trajnimit që deri diku adresojnë kërkesat për sigurim të cilësisë së programeve të trajnimit: 1. Sigurimi i cilësisë së programit të trajnimit; 2. Shtrirja e programit të trajnimit. Kjo ka ndikuar që vlerësimet për aprovimin e programeve të trajnimeve të realizohen në bazë të këtyre kërkësave (Mehmeti S, Rraci E, Bajrami K, 2019).

Sigurimi i një mjedisi të favorshëm në shkollë për zbatimin e kurrikulës kërkon angazhim të të gjithë stafit të shkollës ku përfshihen: nxënësit, mësimdhënësit, shërbimi profesional i shkollës, drejtori i shkollës, këshilli i nxënësve, këshilli i prindërve, këshilli drejtues i shkollës. Zbatimi i kurrikulës në shkollë duhet ta parashihet edhe në planin zhvillimor të shkollës

(MASHT, 2016). Përafrimi i kurrikulës me parimet e të nxënit të shekullit XXI nuk është një detyrë e lehtë. Kërkon një përpjekje të bashkërenduar midis zhvilluesve të kurrikulës, drejtuesve të shkollave dhe mësuesve për kurrikulën, për të përfshirë plotësisht këto parime në çdo program mësimor. Mësuesit janë thelbësorë në zbatimin e kurrikulës sepse ata mbajnë një përgjegjësi të konsiderushme për ndryshimin e kurrikulës (Barrot, J. 2018)

Për të arritur sa më lehtë realizimin e përmbajtjes së lëndës Njeriu dhe natyra, mësimdhënësi përzgjedhë metodologjitë më adekuate, si dhe brenda saj përdor teknika dhe forma të ndryshme duke ia përshtatur moshës, nevojave dhe mundësive të nxënësve. Në bazë të përmbajtjes së temave, mësimdhënësi përdor mjete, material dhe prova të ndryshme me qëllim të realizimit të aktiviteteve në menyrë praktike. Lënda, Njeriu dhe natyra kërkon nga mësimdhënësi një qasje menaxhuese duke përdorur forma ndërvepruese, gjithëpërfshirëse, ekipore dhe krijuese gjatë mesimdhënies dhe mësimnxënies (MASHT, 2018).

1.1 Korniza Kurrikulare

Termi “Kornizë Kurrikulare” nga Marsh (2009) mund të përkufizohet si një grup lëndësh ose temash të ndërlikuara që përshtaten së bashku sipas një grupi të përcaktuar kriteresh, në mënyrë që të mbulojnë më mirë një përmbajtje të caktuar. Korniza e Kurrikulës së Kosovës synon të përgatisë qytetarët që të përballen me sfida të reja dhe të prodhojnë njohuri konkurruese në mënyrë aktive në tregun global të punës. Në Kosovë, sipas KK lëndët grupohen në fusha të kurrikulës Gjuhë dhe Komunikim, Arte, Matematika, Shkencat e Natyrës, Shoqëria dhe Mjedisi, Shëndeti dhe Mirëqenia, Jeta dhe Puna (Ismajli,H. & Krasniqi, D. 2018).

Në KK të Arsimit Parauniversitar parashihet që qëllimet e arsimit te të rinjtë\të rejat të arrihen nëpërmjet zhvillimit të dijes, të shkathtësive, të qëndrimeve dhe të vlerave që i kërkon shoqëria demokratike. Kjo u mundëson të rinjve të jenë qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm, të përballen në mënyrë konstruktive me dallimet dhe sfidat si dhe të respektojnë të drejtat e tyre dhe të drejtat e të tjerëve. Nxënësit do të aftësohen që të shfrytëzojnë në mënyrë kreative\krijuese dijen dhe shkathtësitë e tyre në situata të ndryshme dhe kontekste të reja; të angazhohen në

mënyrë individuale dhe në bashkëpunim me të tjerët në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve si dhe të ushtrojnë shkathtësitë për mendime të pavarura dhe kritike (MASHT, 2016).

Kurrikula Bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor, krahas dokumenteve tjera kurrikulare, e bën të zbatueshme Kornizën e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar, të miratuar nga MASHT-i 2016. Me këtë dokument përcaktohen rezultatet për kompetenca dhe rezultatet për fusha të kurrikulës, të shprehura në njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që duhet të zhvillohen dhe arrihen nga nxënësit. Gjithashtu, ky dokument përcakton shpërndarjen e kohës mësimore (orëve mësimore) për fusha të kurrikulës dhe ndërlidhjen e tyre, të cilat mundësojnë progres në zhvillimin e kompetencave të nxënësit. Kurrikula e arsimit parauniversitar është e organizuar në shtatë fusha të kurrikulës. Ato janë bazë e organizimit të procesit mësimor-edukativ në shkollë, për çdo nivel arsimor dhe shkallë përkatëse të kurrikulës. Një fushë kurrikulare përfshin një ose më shumë lëndë mësimore apo module. Fokusi kryesor i të mësuarit në fushën Shkencat e natyrës përmban bazën e të kuptuarit të botës përmes koncepteve në lëndën mësimore Njeriu dhe natyra. Kurrikula në shkencat e natyrës, ndihmon në zhvillimin e kompetencave të cilat u ndihmojnë nxënësve në aspektin social, shëndetësor e ekonomik dhe që lidhen me çështje të ndryshme në nivel kombëtar dhe global. Konceptet e përgjithshme të fushës kurrikulare në Shkencat e natyrës janë: materia, vetitë dhe shndërrimet, proceset fizike, bota e gjallë, Toka, mjedisi dhe gjithësia (Korrikula bërthamë MASHT, 2016).

Korniza e Kurrikulës është e strukturuar sipas gjashtë shkallëve të Kurrikulës, të cilat paraqesin periudha me karakteristika të përbashkëta për sa i përket zhvillimit të fëmijëve dhe kërkesave të Kurrikulës. Shkallat e kurrikulës në interes për temën që do të zhvillohet janë:

- shkalla e kurrikulës 1: përvetësim themelor që përfshinë klasën parafillore, klasën e parë dhe klasën e dytë;
- shkalla e kurrikulës 2: përforcim dhe zhvillim përfshinë klasën e tretë dhe të katërt
- shkalla e kurrikulës 3: zhvillim i mëtejmë dhe orientim përfshinë klasën e pestë dhe të gjashtë (Korniza e kurrikulës MASHT, 2011).

Kompetencat e parapara me kornizën kurrikulare rrjedhin nga qëllimet e përgjithshme të arsimit parauniversitar dhe përcaktojnë rezultatet kryesore të të nxënit, të cilat duhet t’i arrijnë nxënësit në mënyrë progresive dhe të qëndrueshme gjatë sistemit të arsimit parauniversitar. Këto kompetenca janë:

- Kompetenca e kumunikimit dhe të shprehurit: me qëllim që femijët dhe të rinjtë të zhvillohen si personalitet, të mësojnë dhe të marrin pjesë aktive në shoqëri. Është me rëndësi t'i kuptojnë porositë që u drejtohen dhe të shprehen në mënyrë adekuate.
- Kompetenca e të menduarit (mendimtar kreativ (krijues dhe kritik)): qasja në njohuri dhe përpunimi i tyre në mënyrë të pavarur, efektive dhe me përgjegjësi është shumë e rëndësishme për të nxënë, për të marrë vendime dhe veprime për të zgjidhur probleme në mënyrë të vetëdijshme për të ndikimin dhe pasojat e tyre.
- Kompetenca e të mësuarit (Nxënës i suksesshëm): në zhvillimet bashkëkohore në shoqëri, në shkencë, në teknologji e në ekonomi, nuk mund të kërkohet që të gjitha njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e nevojshme të arrihen nëpërmjet shkollimit.
- Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis (Kontribues produktiv): shkolla angazhohet që nxënësi\ja të përgatitet të punojë në mënyrë të pavarur dhe të vetëdijësohet për rolin dhe përgjigjësinë e tij në mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit.
- Kompetenca personale (Individ i shëndeshëm): për të zhvilluar kompetencën personale, shkolla përgatit nxënës, që në mënyrë efektive dhe konstruktive të inkuadrohen në jetën familjare, shoqërore dhe të punës.
- Kompetenca qytetare (Qytetar i përgjegjshëm): shkolla përgatit nxënësin/en për të jetuar së bashku me të tjerët dhe për të tejkaluar sfidat kryesore me të cilat ballafaqohet në jetën e përditshme.

Kompetencat reflektohen nëpërmjet rezultateve të të nxënit, të cilat janë të përgjithshme e të cilat shprehin atë se cfarë duhet të arrijnë nxënësit në mënyrë progresive dhe të vazhdueshme deri në fund të arsimit të detyrueshëm (Kurrikula Bërthamë MASHT,2016).

1.2 Zbatimi i kurrikulës

Sipas kornizës së kurrikulës së arsimit parauniversitar të Kosovës, mënyra se si është organizuar kurrikula në cilindo sistem, përfshin lëndët dhe fushat e kurrikulës, kur ato duhet të mësohen dhe 'modelin' me të cilin ato duhet të mësohen. Kurrikula mund të përbëhet, për shembull prej lëndëve kryesore dhe zgjedhore që mësohen me disa ndryshime midis klasave të

ndryshme. Kurrikula siguron autonomi të shtuar në nivel shkolle për të planifikuar dhe për të vepruar në zbatimin e kurrikulës në përputhje me kushtet specifike të kuadrit mësimor, infrastrukturës së shkollës dhe specifikave të lokalitetit në të cilin vepron shkolla. Në këtë mënyrë secilës shkollë i mundësohet që të ndërtojë profilin e vet në interesin më të mirë të nxënësve të saj dhe të lokalitetit në të cilin vepron. Mësimdhënësit shfrytëzojnë fleksibilitetin e shtuar për planifikimin dhe shfrytëzimin e një game të gjerë të metodave mësimore të përshtatshme për qasje interaktive dhe të individualizuar të punës me nxënës, drejt arritjes së rezultateve të përcaktuara të të nxënit. Për të vendosur një bazë të qëndrueshme të zbatimit të Kornizës së Kurrikulës, duhen siguruar:

a) hartimi i dokumenteve;
b) përgatitja e plotë e sistemit shkollor dhe e shkollave individuale për të marrë përsipër zbatimin e kurrikulës;
c) ngritja e kapacitetit të kuadrit drejtues dhe mësimdhënës në shkolla për zbatimin e kurrikulës, përfshirë zhvillimin e vazhdueshëm profesional (Korniza e Kurrikulës,2011).

Faktorët që mund të ndihmojnë ose pengojnë zbatimin e reformës kurrikulare arsimore mund të jenë të brendshëm dhe të jashtëm. Faktorët e brendshëm mund të jenë: angazhimi, vet-efikasiteti dhe motivimi. Faktorët e jashtëm mund të jenë: menaxhimi, bashkëpunimi profesional, koha dhe burimet. Këta faktorë mund të shihet se kontribuojnë në reforma kurrikulare arsimore, por ata gjithashtu mund të shihen si pengesa ose përcaktues të dështimit, në rast se ka mungesë te tiparët e lartpërmendura (Ali Demaj F, 2019).

Filozofia e kornizës kurrikulare dhe kurrikulës bërthamë, kërkon qasje të ndryshme të mësimdhënies dhe kjo do të thotë:

- Aplikimin e metodave dhe teknikave të ndryshme, të cilat u mundësojnë të gjithë nxënësve ndërlidhjen në procesin e të nxënit, sepse disa mund të mësojnë duke vizatuar, disa duke lexuar, disa duke dëgjuar, disa duke shikuar, disa duke lëvizur, disa me gjëra konkrete e disa në mënyrë abstrakte për detyrën e njëjtë.
- Aplikimin e mësimdhëniës që u mundëson nxënësve të nxënë duke vepruar, si në rastin e mësimit të përdorimit të teknologjisë, sepse nxënësit nxënë duke bërë vetë hulumtimin, si në rastin e mësimit elementeve të kuminikacionit në rrugë.

- Aplikimi i mësimdhënies që mundëson të nxënit duke ndërvepruar, nxënësit veprojnë në ndonjë objekt, ngjarje apo dukuri dhe efektet e tyre ndikojnë te nxënësit, sepse përvoja që ata kalojnë gjatë këtyre proceseve u ndihmon të bëjnë apo të mos bëjnë gjërat e njëjta.
- Aplikimin e mësimdhënies që mundëson të nxënit duke bashkëpunuar. Kujto punën e grupeve, ekipe, çifte.
- Aplikimin e mësimdhënies duke hulumtuar, sepse nxënësit vetë i gjejnë burimet e informacionit, vetë hulumtojnë (ndajnë detyrat, caktojnë metodat, instrumentet, kriteret dhe vetë përgatisin prezantimin e gjetjeve)(Gërguri, B & Kurtishi, Z & Mejtani, K. 2016).

Smith dhe Lovat (2003) besojnë se angazhimi i mësuesve është thelbësor për ndryshimet e suksesshme në shkolla. Angazhimi i mësuesve është i rëndësishëm sepse mësuesit e përkushtuar do të jenë më të motivuar për të dhënë më të mirën për studentët\nxënësit e tyrë, dhe kjo do t'i çojë ata drejt arritjes së qëllimeve të shkollës. Angazhimi i mësuesve është shumë dimensional. Angazhimi individual i mësuesve supozohet të analizohet për të identifikuar qendrat e angazhimit në praktikat e tyre profesionale (Ali Demaj F, 2019).

Disa nga vështirësitë e zbatimit te kurrikulës janë si p.sh: mungesa e përgatitjes paraprake të mësimdhënsve për t'u përshtatur me ndryshimet e reja, në zbatimin e planit dhe programit, ka krijuar vështirësi të mëdha në procesin e mësimdhënies dhe arritjen e rezultateve cilësore në punën e tyre. I tërë procesi bëhet edhe me i vështirë me ndryshimin e teksteve shkollore, e cila shpesh nuk ka qenë ne përputhje me zbatimin e objektivave të përcaktuara me programet mësimore për klasat e veçanta (BekaA, 2013).

Korniza e Kurrikulës është e ndërtuar mbi parime që vlejnë për tërë sistemin e arsimit parauniversitar. Ato sigurojnë koherencën dhe konsistencën e këtij sistemi. Parimet janë referenca për hartimin e kurrikulave bërthamë dhe të të gjitha dokumenteve të tjera kurrikulare. Parimet për zhvillimin dhe zbatimin e kornizës kurrikulare janë :

- Gjithëpërfshirja, i referohet të drejtës së secilit fëmijë dhe të ri, për përfshirje të barabartë në arsim cilësor.
- Zhvillimi i kompetencave, Korniza kurrikulare përcakton qartë kompetencat, të cilat shoqëria i konsideron të domosdoshme për të gjithët qytetarët.
- Mësimdhënia dhe të nxënit e integruar dhe koherent/të ndërlidhur, reflekton ndërlidhjet dhe ndërvarësitë e natyrës dhe botës së krijuar nga njeriu me dijen dhe informacionin që nxënësit kanë për to.

- Autonomia dhe fleksibiliteti në nivel shkolle, me kornizën e kurrikulës rregullon qartë normat e autonomisë dhe fleksibilitetit në nivele shkollore. Kjo ka të bëjë me mundësinë dhe përgjegjësinë e stafit të shkollës për: hartimin e planit vjetor të punës dhe shfrytëzimin fleksibil të kohës mësimore etj.
- Përgjigjësia dhe llogaridhënia: Korniza kurrikulare, krahas promovimit të autonomisë dhe fleksibilitetit në nivele shkollore, parasheh edhe vendosjen e një mekanizmi të llogaridhënies për tërë hierarkinë e sistemit të arsimit (Korniza Kurrikulare MASHT, 2016).

1.3 Planprogrami

Plani mësimor ndahet për fusha kurrikulare në mënyrë të baraspeshuar, duke pasur parasysh moshën e nxënësve dhe nevojat e tyre zhvillimore. Koha e përcaktuar në këtë plan mësimor, nënkupton minimumin e kohës për secilën fushë të kurrikulës (Korniza Kurrikulare,2016).

Në mbështetje të specifikave të mësimdhënies dhe nxënies në klasën përgatitore dhe arsimin fillor me qëllim që plani mësimor të jetë funksional në zhvillimin e kompetencave të parapara me KK, gjatë hartimit të planit mësimor për klasën përgatitore dhe klasat 1-5 janë marrë parasysh kriteret në vijim:

- përqindja totale e dhënë në planin mësimor për secilën fushë kurrikulare për një shkallë kurrikulare;
- numri i orëve javore për një klasë;
- rezultatet e të nxënit për fushën kurrikulare, që duhen zotëruar nga nxënësit gjatë një shkalle kurrikulare;
- rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore për shkallë kurrikulare;
- mundësitë psikofizike dhe intelektuale të nxënësve;
- parapërgatitja dhe përvojat e nxënësve; dhe
- konteksti aktual i përgatitjes së mësimdhënësve për këtë nivel të arsimit (Kurrikula bërthamë, 2016)

Plani dhe programi mësimor për klasa ka për qëllim:

- vazhdimin e ndërtimit të vlerave shpirtërore të nxënësit;
- konsolidimin e diturive, ngritjen, orientimin e prirjeve dhe të shkathtësive në ndërtimin e së ardhmes së tyre;
- inkurajimin e nxënësve për të marrë iniciativën e veprimt të pavarur në rrethinë familjare e më gjërë, duke respektuar rregullat themelore të sjelljes në grupe;

Që të realizohet mësimdhënia dhe mësimnxënia e këtij plani dhe programi, mësimdhënësit dhe nxënësit duhet të shfrytëzojnë burimet dhe mjete të ndryshme informimi. Deri tash burimi kryesor i informimit ishte teksti shkollor i lëndës përkatëse. Nëse mungon një tekst adekuat për lëndën përkatëse, mësimdhënësit dhe nxënësit kanë mundësi të shfrytëzojnë tekste të ndryshme. Krahas teksteve të ndryshme shkollore, sugjerojmë të përdoren edhe materiale të tjera informimi:

-doracakë, atlasë, broshura;

-gazeta, revista profesionale dhe shkencore;

-fotografi, posterë, skema, diagrame, harta, tabela; (Plane dhe programi mësimor MASHT, 2003).

Është kompetencë e arsimtarit që, varësisht nga kushtet në të cilat punon, shkolla i zgjedh burimet e informacionit dhe mjetet ndihmëse mësimore, duke i kushtuar vëmendje baraspeshës së të dhënave gojore, vizuale, auditive dhe audiovizuele, me theks të veçantë në atë që është qenësore për t'u mësuar. Kjo liri e të zgjedhurit të burimeve mësimore duhet t'i takojë edhe nxënësit (Plani dhe programi mësimor MASHT, 2004).

Shkolla duhet t'i identifikojë me prioritetet për të siguruar kushtet elementare për zbatimin e kurrikulës së re në përpilimin e planit vjetor. Disa nga këto intervenime mund të jenë:

- zhvillimi profesional i mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës;
- sigurimi i një mjedisi mundësues për zbatim të kurrikulës;
- funksionalizimi i organeve qeveritare të shkollës;
- funksionalizimi i organeve profesionale të shkollës; dhe
- vendosja dhe konsolidimi i shërbimeve profesionale.

Sipas Kurrikulës Bërthamë, shkolla është e obliguar që t'u bëjë të mundur gjithë nxënësve të kalojnë minimumin e kohës mësimore të përcaktuar me plan mësimor. Mbi këtë minimum mund të përcaktojë kohë mësimore (orë mësimore) edhe për aktivitete jashtëkurrikulare (Instituti Pedagogjik i Kosovës,2016).

1.4 Shkencat e natyrës

Për secilën fushë kurrikulare janë përcaktuar rezultatet e të nxënit, të cilat e orientojnë procesin e mësimdhënies dhe të nxënit në zhvillimin e kompetencave kryesore. Rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare sigurojnë:

- Zhvillimin e kompetencave përmes një tërësie të përbashkët mësimore të ndërlidhura.
- Lidhjen/ koherencën ndërmjet lëndëvë dhe veprimtarive mësimore, që realizohen në kuadër të një fushe të kurrikulës, me synim integrimin e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që mundësojnë këto lëndë.
- Zbatimin e praktikave të reja të mësimdhënies në nivel klase/shkolle.

Secila nga fushat e kurrikulës, nga pikëpamja e organizmit të materialit, paraqitet sipas formatit të mëposhtëm:

-hyrje,

-qëllimi,

-konceptet e përgjithshme dhe përshkrimi i tyre,

-rezultatet e të nxënit,

- udhëzime për vlerësim,

- materialet dhe burimet mësimore.

Fusha Shkencat e natyrës përmban bazën e të kuptuarit të botës përmes koncepteve në lëndën mësimore Njeriu dhe natyra. Nxënësit, që në moshë të hershme, njihen me dukuritë shkencore si tërësi dhe ndikimin e tyre në funksionimin e shoqërisë dhe natyrës (Kurrikula Bërthamë MASHT, 2016).

Shkencat natyrore u mundësojnë nxënësve për të njohur, për të hulumtuar natyrën, botën e gjallë e jo të gjallë dhe njeriun, duke filluar nga mikrokozmosi deri në makrokozmosi. Shkencat natyrore përfaqësojnë fushën kurrikulare që nxënësve u ofron mundësi të zhvillojnë të kupuarit e koncepteve, të teorive, të ligjshmërive dhe dukurive fundamentale të natyrës. Ato kontribuojnë në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë, ndihmojnë në ngritjen e nivelit teknologjik dhe zhvillimit ekonomik, rritjen e cilësisë së jetës së njeriut, ruajtjen e shëndetit, mjedisit jetësor dhe mirëqenies. Në Shkallën e parë dhe në Shkallën e dytë, nxënësit do të mësojnë për mjedisin

natyror dhe të krijuar nga njeriu, metodat hulumtuese për studimin e proceseve dhe të dukurive natyrore (Korniza Kurrikulare MASHT, 2016)

Temat ndërkurrikulare që mund të integrohen në Kurrikulën e Shkencave të Natyrës, për klasën e parë të nxënësve janë:

- edukimi për media;
- arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm.

Edukimi për media i referohet njohjes së llojeve të mediave që shpërndajnë informacione të reja dhe të sakta, për hulumtimet dhe zbulimet e reja shkencore. Çështja e edukimit për media përfshin përmbajtjet lidhur me publikimet, shpërblimet për të arriturat në shkencë në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar.

Arsimi për zhvillim të qëndrushëm- i referohet temave me rëndësi të përgjithshme të cilat ndikojnë në formësimin e nxënësve për një qëndrim të ndërgjegjshëm ndaj çështjeve në vetëdijësimin dhe ruajtjen e pasurive natyrore, në nivel shkolle dhe mjedisit ku jeton. Këtu hyjnë çështje si: aspekti social, ekonomia familjare, riciklimi etj. (MASHT, 2018).

Në të njëjtën kohë, shkencat natyrore janë kryesisht ato eksperimentale. Perceptimi efektiv i njohurive të nxënësve në shkencat natyrore, dhe më vonë në Fizikë, Kimi, Biologji dhe Astronomi varet jo vetëm nga mënyra e paraqitjes së teorisë, por edhe nga përmbushja e pjesës eksperimentale në punë praktike dhe eksperimente laboratorike, e cila kërkon dije të zgjeruar teorike si nga mësuesi\ja ashtu edhe nga nxënësit. Në ditët e sotme, sistemi i arsimit fillor po ndryshon thelbësisht. Një aspekt i rëndësishëm i arsimit është zhvillimi i aftësive të një nxënësi "për të mësuar vetë". Konteksti dhe metodat e arsimit në shkollën fillore kanë për qëllim zhvillimin e përqëndrimit, kujtesës, mendimit krijues, për trajnimin e aftësive për të krahasuar, theksuar karakteristikat e veçanta të objektivave (Midak, L. et al, 2020).

1.5 Zbatimi i kurrikulës te shkencat e natyrës.

Korniza e Kurrikulës parasheh që udhëheqja e shkollës të punojë në bashkëpunim me të gjitha palët e interesuar për: zhvillimin e një koncepti të qartë për shkollën, përfshirë vizionin

dhe misionin e shkollës, dhe për përmirësimin e cilësisë, barazisë dhe llogaridhënies mbi cilësinë e shërbimeve arsimore (Instituti Pedagogjik i Kosovës, 2016).

Njohja e rolit kryesor që do të luajë në ndërmjetësimin e zbatimit të reformës është jetike për suksesin e saj pasi perceptimet dhe besimet mund të ndikojnë dhe të formojnë kuptime që mësimdhënësit u bashkangjitin reformave të reja dhe zbatimit në klasë. Kërkimet sugjerojnë gatishmërinë e mësuesve për t'u përfshirë në reformat e kurrikulës (Brain, Reid, & Boyes, 2006; O'Donnell, 2005; Orafi & Borg, 2009; Hardman, J &Rahman, N,2014)

Qëllimet e arsimit parauniversitar të paraqitur në Kornizën Kurrikulare të Kosovës janë pjesë përbërse e dokumenteve të kurrikulave bërthamë të të tri niveleve formale të arsimit parauniversitar. E gjithë përmbajtja e këtyre dokumenteve është në funksion të arritshmërisë së qëllimeve të arsimit parauniversitar. Kjo do të thotë që edhe rezultatet e të nxënit për shkallë kurrikulare-kompetenca (RNSH) dhe rezultatet e të nxënit të fushave kurrikulare (RNF) të secilës shkallë kurrikulare janë në funksion të arritjes së qëllimeve të arsimit parauniversitar. Qasja e arritjes së qëllimeve duhet t'u përshtaten moshës dhe mundësive të nxënësve të secilit nivel formal, përkatësisht secilës klasë. Sipas Kurrikulës Bërthamë, secili nivel i arsimit parauniversitar te nxënësit duhet të zhvillojë dijen, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat në harmoni me kërkesat e shoqërisë demokratike dhe nëpërmjet tyre në arritjen e qëllimeve të arsimit (Krastrati, R. & Avdylaj, M. 2014).

Sipas MASHT-it mësimdhënësi përdor mjete, materiale dhe prova të ndryshme në bazë të kërkesave që dalin për realizimin e njësisë së caktuar mësimore. Shkencat e natyrës si shkenca eksperimentale, kërkojnë nga mësimdhënësi që të jetë më shumë në rolin e menaxhuesit duke përdorur qasje krijuese, gjithëpërfshirëse, ndërvepruese dhe ekipore.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave për nxënie cilësore, sugjerohen qasje metodologjike si më poshtë:

- mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembuj);
- mësimdhënie jo e drejtpërdrejtë (vëzhgim, provë, zgjidhja e problemeve);
- mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);
- diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);
- mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;
- të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren etj;

Në të gjitha rastet zbatimi i metodave apo teknikave duhet të shoqërohet me përdorimin e teknikave dhe materialeve dhe të mjeteve didaktike pa të cilat nuk mund të arrihen rezultatet e pritura (MASHT, 2018).

Mësimdhënësi gjatë aktiviteteve në klasë, shkollë, natyrë etj., duhet t'i nxitë nxënësit, të njohin, vrojtojnë, radhitin, matin, shënojnë, mbledhin të dhëna, provojnë, mendojnë në mënyrë të pavarur si dhe të japin mendimet e tyre. Për të arritur sa më lehtë realizimin e përmbajtjes së lëndës Njeriu dhe natyra, mësimdhënësi përzgjedh metodologjitë më adekuate, si dhe brenda saj përdor teknika dhe forma të ndryshme duke iu përshtatur moshës, nevojave dhe mundësive të nxënësve. Çështja e edukimit për media përfshin përmbajtjet lidhur publikimet, shpërblimet për të arriturat në shkencë në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar (MASHT, 2018).

Si burim informacionit përveç tekstit shkollor është e domosdoshme të përdoren edhe burime të tjera si CD (filma, dokumentarë, video, eksperimente etj), interneti (material tekstuale, fotografi, programe interaktive, etj), enciklopedi, atlase, material reciklues, dhe material të marrë nga natyra etj. Përdorimi i materialeve të llojllojshme dhe përshtatshme me temat dhe moshën e nxënësve, rrit interesimin dhe kureshtjen e nxënësve për të nxënë (Kurrikula Bërthamë MASHT, 2016).

2.METODOLOGJIA

2.1 Dizajni i hulumtimit

Hulumtimi 'Zbatimi i kurrikulës te shkencat e natyrës në shkollat fillore në Komunën e Vushtrrisë', është hulumtim me qasje sasiore. Qëllimi i këtij hulumtimi është ta kuptojmë sesa e përshtatshme është Kurrikula e Shkencave Natyrore për aplikim gjatëmbajtjes së orës mësimore në shkollat e Vushtrrisë dhe rrethinë. Po ashtu shqyrtimi se si ndikon në punën e mësimdhënësve.

Hipotezat e ketij hulumtimi janë:

H1. Kurrikula për shkencat e natyrës është e përshtatshme për zbatim gjatë orës mësimore.

H2. Mësimdhënësit janë të kënaqur me suksesin e kurrikulës në shkencat e natyrës.

2.1 Pjesëmarrësit

Pjesëmarrës të këtij hulumtimi janë mësimdhënësit e katër shkollave në Komunën e Vushtrrisë; dy shkolla nga fshatrat: "Lumni Surdulli"e Samadrexhës "Rilindja" e Maxhunaj; dy shkolla nga qyteti: "Naim Frashëri" dhe " Mustafë Venhari". Në këtë hulumtim u testuan 20 mësimdhënës nga shkollat e lartpërmenduara, të cilët janë zgjedhur në mënyrë të rastësishme. Pyetësori është shpërndarë online për shkak të situatës së krijuar nga pandemia.

Të dhënat demografike tregojnë se në këtë hulumtim morën pjesë 20 mësimdhënës nga kumuna e Vushtrrisë. Nga të dhënat në tabelën e mësipërme, konstatojmë që 95% e pjesëmarrësve në hulumtim janë femra, ndërkohë që vetëm 5% e tyre janë meshkuj. Gjithashtu, të dhënat për vendbanim, tregojnë që 45% e pjesëmarrësve në studim janë nga zona rurale dhe 55% janë nga zona urbane. Sa i përket nivelit arsimor që kanë pjesëmarrësit, ata janë përgjigjur që 5% e pjesëmarrësve në hulumtim kanë kryer shkollën normale, 75% e tyre kanë përfunduar bachelorin dhe 20% nga pjesëmarrësit kanë përfunduar masterin. Mosha e pjesëmarrësve, nga të dhënat e nxjerra prej pyetësorit, është e larmishme: 45% e pjesëmarrësve i përkasin moshës deri në 50 vjeç, ndërkohë që 5% i përkasin moshës 50 vjeç dhe 50% e pjesëmarrësve janë mbi moshën 50 vjeç. Në tabelën e mësipërme shihet se edhe përvoja e punës së mësimdhënësve pjesëmarrës ne hulumtim, është e ndryshme: 55% e tyre kanë një përvojë punë në mësimdhënie

mbi 11 vjet, ndërkohë që 25% e tyre kanë 6 deri 10 vjet përvojë pune dhe vetëm 20% e tyre deklarojnë se kanë 2 deri në 5 vjet eksperiencë në mësimdhënie.

2.2 Instrumentet

Për mbledhjen e të dhënave në hulumtim është përdorur pyetësori si instrument matës. Pyetësori përmban gjithsej 16 pyetje dhe është pyetësor i formuluar për mësimdhënësit e klasave të para deri në klasën e pestë. Ky pyetësor përmban pyetje demografike në lidhje me gjininë, moshën, shkollimin dhe përvojën që ata kanë në mësimdhënie. Përveç pyetjeve demografike, janë përdorur pyetje të tjera, sesa janë të informuar për mundësitë dhe kërkesat e kurrikulës në Shkencat e Natyrës, për klasën e parë deri në klasën e pestë. Përgjigjet janë siguruar nga mësimdhënësit në shkollat fillore në Vushtrri dhe në rrethinë. Të gjitha pyetjet kanë qenë të formuluar në lidhje me zbatimin e kurrikulës në Shkencat e Natyrës.

2.3 Mënyra e mbledhjes së të dhënave

Nga shkollat fillore në komunën e Vushtrrisë, ne kemi zgjedhur si mostër nga pesë mësimdhënës nga katër shkolla. Mbledhja e të dhënave si proces ka zgjatur 4 ditë, nga data 22.09.2020 deri më 25.09.2020. Pyetësori është shpërndarë online te mësimdhënësit dhe janë dhënë të gjitha shpjegimet e nevojshme rreth tij, pyetjet dhe sqarimet e nevojshme rreth arsyes së hulumtimit. Mbledhja e të dhënave është bërë te shkollat fillore: “Lumni Surdulli” e Samadrexhës,“Rilindja” e Maxhunajt; “Naim Frashëri” dhe “Mustafë Venhari” të qytetit .Shkollat “Lumni Surdulli” dhe “Rilindja”, janë nga zona rurale, ndërsa shkollat: “Naim Frashëri”, “Mustafë Venhari”, janë të zonës urbane.

2.4 Analizat

Për të analizuar dhe llogaritur të dhënat është përdorur Pakoja Statistikore e Shkencave Sociale SPSS. Analizat që janë përdorur janë: analiza përshkruese dhe korrelacioni\lidhshmëria. Kjo e fundit është përdorur për vërtetimin e hipotezave.

Rezultatet janë paraqitur në formë tabelare, dhe interpretimi i tyre është bërë duke paraqitur të dhënat që janë përshkruar nga tabelat.

2.5 Aspekti etik

Gjatë realizimit të hulumtimit është respektuar etika e hulumtimit. Natyrisht që etika duhet respektuar në çdo punim, për arsye se është e rregulluar në atë mënyrë që të mos cenohen të drejtat e individëve të cilët janë pjesëmarrës në studim. Pyetësori është shpërndarë online. Mësimdhënësit kanë marrë pjesë në të në mënyrë vullnetare. Që në faqen e parë të hulumtimit, u është sqaruar se përgjigjet nga ata, do të përdoren vetëm për qëllime të këtij hulumtimit dhe që do të ruhet privatësia e tyre. Të dhënat në këtë hulumtim janë paraqitur të përmbledhura. Ato nuk japin informacione të hollësishme, në mënyrë që të mos identifikohen pjesëmarrësit apo institucionet e tyre ku ata punojnë. Arsyeja është se ata, duke qenë anonimë, të përgjigjen pa hezitim dhe të japin përgjigjet duke u bazuar në zbatimin e kurrikulës. Në lidhje me këtë kemi informuar secilin nga pjesëmarrësit, para plotësimit të pyetësorit rreth përmbajtjes së tij, me qëllim që përgjigjet të jenë sa më orgjinale.

3.REZULTATE

Për rezultatet e nxjerra nga pyetësori, janë përdorur 16 pyetje për të matur sesa zbatohet kurrikula e Shkencave të natyrës në katër shkolla të Vushtrrisë.

Pjesëmarrësit në këtë hulumtim u pyetën për vështirësitë e zbatimit të kurrikulës së Shkencave të natyrës gjatë orës mësimore; rreth aftësimit të tyre nga trajnimet e bëra për të lehtësuar zbatimin e kurrikulës; shkallës së informimit rreth mundësive dhe kërkesave të kurrikulës; arritjes së rezultateve në të nxënit për kompetenca; punës për planifikimin dhe përgatitjen e orës; mundësisë ose pamundësisë për ndyshimin e saj.

Paraqitja tabelare e të dhënave nga pjesa e parë e pyetësorit

Tabela 1. *Te dhënat demografike për pjesëmarrësit, gjinia, vendbanimi, niveli arsimor, mosha dhe përvoja si mësimdhënës.*

	N	%
Gjinia		
Femer	19	95
Mashkull	1	5
Vendbanimi		
Rural	9	45
Urban	11	55
Niveli i arsimimi		
Shkolla normale	1	5
Bachelor	15	75
Master	4	20
Mosha		
>50	9	45

50	1	5
<50	10	50
Përvoja si mësimdhënës		
2-5	4	20
6-10	5	25
<11	11	55

Paraqitja tabelare e të dhënave nga pjesa e dytë e pyetësorit.

Tabela 2. *Paraqitja tabelare sesa janë të informuar mësimdhënësit për mundësiët dhe kërkesat e kurrikulës.*

Sa jeni të informuar për mundësitë dhe kërkesat e kurrikulës në Shkencat e natyrës?	N	%
Nuk pajtohem.	3	15%
Nuk e di.	2	10%
Pajtohem.	11	55%
Pajtohem tërësisht.	4	20%



Grafiku 1: *Paraqitja në formë grafike e pyetjes së gjashtë.*

Tabela 3.*Paraqitja tabelare sesa është e përshtatshme kurrikula për zbatim.*

A është e përshtatshme për zbatim kurrikula në Shkencat e natyrës?	N	%
Nuk pajtohem.	2	10%
Nuk e di.	3	15%
Pajtohem.	14	70%
Pajtohem tërësisht.	1	5%



Grafiku 2: Paraqitja në formë grafike e pyetjes së shtatë.

Tabela 4.*Paraqitja tabelarese sesa janë të arritshme rezultatet për kompetenca kryesore.*

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës, a janë të arritshme nga nxënësit?	N	%
Nuk pajtohem.	3	15%
Nuk e di.	1	5%
Pajtohem.	13	65%
Pajtohem tërësisht.	3	15%

Grafiku 3: Paraqitja në formë grafike e pyetjes së tetë.

Tabela 5.*Paraqitja tabelare sesa ka ndryshuar planifikimi për orë mësimore.*

A ka ndryshuar puna administrative rreth planifikimit dhe përgatitjes së orës mësimore, sipas KKK-së?	N	%
Nuk pajtohem.	-	-
Nuk e di.	-	-
Pajtohem.	11	55%
Pajtohem tërësisht.	9	45%



Grafiku 4: Paraqitja në formë grafike e pyetjes së nëntë.

Tabela 6.*Paraqitja tabelare se a janë në harmoni planet ditore me ato vjetore.*

A janë në harmoni planifikimet ditore me planet vjetore?	N	%
Nuk pajtohem.	-	-
Nuk e di.	-	-
Pajtohem.	11	55%
Pajtohem tërësisht.	9	45%



Grafiku 5: Paraqitja në formë grafike e pyetjes së dhjetë.

Tabela 7.*Paraqitja tabelare se a ju ndihmon KKK-ja në planifikim.*

A ju ndihmojnë udhëzuesit e KKK-së në planifikimet tuaja?	N	%
Nuk pajtohem.	-	-
Nuk e di.	1	5%
Pajtohem.	14	70%
Pajtohem tërësisht.	5	25%



Grafiku 6: Paraqitja në formë grafike e pyetjes së njëmbëdhjetë.

Tabela 8.*Paraqitja tabelare se a janë të mjaftueshme trajnimet që kanë ndjekur për zbatimin e kurrikulës.*

A janë të mjaftueshme trajnimet që keni ndjekur për zbatimin e kurrikulës në Shkencat e natyrës?	N	%
Nuk pajtohem.	7	35%
Nuk e di.	3	15%
Pajtohem.	6	30%
Pajtohem tërësisht.	4	20%



Grafiku 7: Paraqitja në formë grafike e pyetjes së dymbëdhjetë.

Tabela 9.*Paraqitja tabelare se a zbatohet plani për orë mësimore.*

A zbatohet gjatë orës nga ana juaj Plani i përgatitur për orë mësimore?	N	%
Nuk pajtohem.	7	35%
Nuk e di.	3	15%
Pajtohem.	6	30%
Pajtohem tërësisht.	4	20%



Grafiku 8: Paraqitja në formë grafike e pyetjes së trembëdhjetë.

Tabela 10.*Paraqitja tabelare se a bashkëpunojnë me kolegët për të zgjidhur vështirësitë gjatë zbatimit të kurrikulës.*

A bashkëpunoni me kolegët tuaj për t'i zgjidhur vështirësitë që dalin gjatë zbatimit të kurrikulës në Shkencat e natyrës?	N	%
Nuk pajtohem .	2	10%
Nuk e di.	-	-
Pajtohem.	8	40%
Pajtohem tërësisht.	10	50%



Grafiku 9: Paraqitja në formë grafike e pyetjes së katërmbëdhjetë.

Tabela 11.*Paraqitja tabelare se a bashkëpunojnë me kolegët për të zgjidhur vështirësitë gjatë zbatimit të kurrikulës.*

Në përgjithësi a keni gatishmëri ta zbatoni kurrikulën në shkencat e natyrës?	N	%
Nuk pajtohem.	1	5%
Nuk e di.	1	5%
Pajtohem.	9	45%
Pajtohem tërësisht.	9	45%



Grafiku 10: Paraqitja në formë grafike e pyetjes së pesëmbëdhjetë.

Tabela 12.*Paraqitja tabelare se a bashkëpunojnë me kolegët për t'i zgjidhur vështirësitë gjatë zbatimit të kurrikulës.*

Në përgjithësi a jeni optimistë në suksesin e kurrikulës në Shkencat e natyrës	N	%
Nuk pajtohem.	1	5%
Nuk e di.	-	-
Pajtohem.	10	50%
Pajtohem tërësisht.	9	45%



Grafiku 11: Paraqitja në forme grafike e pyetjes së gjashtëmbëdhjetë.

3.1 Vërtetimi i hipotezave

H1. Kurrikula për shkencat e natyrës është e përshtatshme për zbatimin gjatë orës mësimore.
Tabela 13. *Vërtetimi i hipotezës përmes korrelacionit.*

	Në përgjithësi, a keni gatishmëri ta zbatoni kurrikulën në Shkencat e natyrës?	A është e përshtatshme për zbatim kurrikula në Shkencat e natyrës?

Në përgjithësi, a keni gatishmëri ta zbatoni kurrikulën në Shkencat e natyrës?	Korrelacioni i Pearsonit	1	.520*
	Signifikanca		.019
	N	20	20
Kurrikula në Shkencat e natyrës është e përshtatshme për zbatim.	Korrelacioni i Pearsonit	.520*	1
	Signifikanca	.019	
	N	20	20

H2 Mësimdhënësit janë të kënaqur me suksesin e kurrikulës në Shkencat e natyrës.
Tabela 13.1. *Vërtetimi i hipotezës përmes korrelacionit.*

		16. Në përgjithësi, a jeni optimistë në suksesin e kurrikulës në Shkencat e natyrës?	8. Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës janë të arritshme nga nxënësit.
16. Në përgjithësi, a jeni optimist në suksesin e kurrikulës në Shkencat e natyrës?	Korrelacioni i Pearsonit	1	.663**
	Signifikanca		.001
	N	20	20

8. Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës janë të arritshme nga nxënësit.	Korrelacioni i Pearsonit	.663**	1
	Signifikanca	.001	
	N	20	20

4. DISKUTIMET

Qëllimi i këtij hulumtimi është që të kuptojmë zbatimin e kurrikulës në Shkencat e natyrës në shkollat fillore në Vushtrri dhe në rrethinë, përkatësisht te klasat e I-V, si dhe të diskutojmë rreth rezultateve të dala dhe të vërtetojmë apo të hedhim poshtë hipotezat e krijuara në bazë të pyetjeve hulumtuese. Duke marrë parasysh sfidat që kanë mësimdhënësit gjatë zbatimit të kurrikulës në Shkencat e natyrës janë formuluar pyetjet. Siç kemi cekur edhe më lart në këtë hulumtim kanë marrë pjesë 20 mësimdhënës nga katër shkollat në Vushtrri, nga të cilat dy janë në qytet dhe dy në fshatra. Në analizën e të dhënave sesa janë të informuar për mundësitë dhe kërkesat e kurrikulës në shkencat e natyrës, rezultatet tregojnë se pjesëmarrësit me vendbanim urban janë më të informuar për kërkesat e kurrikulës sesa ata me vendbanim rural, me një përqindje 63.6% me 44.4%. Te pyetja "Kurrikula në shkencat e natyrës, a është e përshtatshme për zbatim?" Sipas nivelit arsimor që kanë përfunduar nga ata me master, 50% nuk pajtoheshin dhe pjesëmarrësit me bachelor 73.3% pajtoheshin për përshtatshmërinë e kurrikulës së shkencave të natyrës, ndërsa sipas vendbanimit me pjesëmarrje vendbanim urban54.5% dhe 88.9% vendbanim rural pajtoheshin. Me rezultatet e pyetjes "Trajnimet që i keni ndjekur, a janë të mjaftueshme për zbatimin e kurrikulës në Shkencat e natyrës?" ,45.5% nga pjesëmarrësit me vendbanim urban nuk pajtoheshin se trajnimet e ndjekura janë të mjaftueshme, kurse 33.3% nga pjesëmarrësit me vendbanim rural nuk e dinë se a janë të mjaftueshme trajnimet . Krahasuar këtë për nga niveli arsimor, del se 33.3% nga pjesëmarrësit me bachelor nuk pajtohen, ndërsa 50% nga pjesëmarrësit me master nuk pajtohen me mjaftueshmërinë e trajnimeve për zbatimin e kurrikulës. Në pyetjen: " A bashkëpunoni me kolegët tuaj për t'i zgjidhur vështirësitë që dalin gjatë zbatimit të kurrikulës në Shkencat e natyrës?" Sipas vendbanimit të pjesmarrësve,ata urban me një përqindje 45.5% pajtohen se bashkëpunojnë me kolegët, ndërsa ata rural, me një përqindje 66.7% pajtohen tërësisht se bashkëpunojnë për t'i zgjidhur vështirësitë që dalin gjatë zbatimit të kurrikulës. Nga niveli arsimor kanë pasur qëndrime të njëjta si pjesëmarrësit me nivelin arsimor master edhe ata me nivel arsimor bachelor. Të gjithë janë përgjigjur se pajtohen. Nga përvoja e punës si mësimdhënës, pjesëmarrësit që kanë nivel 2-5 vjet, pajtohen me një përqindje prej 75%. Përqindje të madhe me 80% është arritur në përgjigjen *pajtohem tërësisht* nga pjesëmarrësit me përvojë të punës 6-10 vjet. Gjithashtu, pjesëmarrësit me përvojë më shumë se 11 vjet, 45.5% prej tyre pajtohen që bashkëpunojnë me kolegët e tyre për t'i zgjidhur

vështirësitë gjatë zbatimit të kurrikulës. Në pyetjen “Në përgjithësi, a keni gatishmëri ta zbatoni kurrikulën në Shkencat e natyrës?” Sipas nivelit arsimor që kanë përfunduar, pjesëmarrësit me master pajtoheshin 75% ndërsa me bachelor 40%. Nga vendbanimi i pjesëmarrësve urban 9.1% nuk pajtoheshin që ishin të gatshëm ta zbatonin kurrikulën, ndërsa 54.5% pajtoheshin tërësisht se ishin të gatshëm ta zbatojnë kurrikulën. Te pyetja: “Në përgjithësi a jeni optimist për suksesin e kurrikulës në shkencat e natyrës?”, 54.5% nga pjesëmarresit me vendbanim urban pajtohen dhe 55.6% nga pjesëmarrësit me vendbanin rural pajtohen tërësisht. Ndërsa sipas nivelit arsimor që kanë përfunduar, pjesëmarrësit që kishin përgatitjen e masterit, 100% nga ta pajtohen se janë optimistë në suksesin e kurrikulës, ndërsa nga pjesëmarrësit me nivel bachelor, 6.7% nuk pajtohen, ndërsa 60% pajtohen tërësisht.

Vërtetimi i hipotezës përmes korrelacionit “Kurrikula për shkencat e natyrës është e përshtatshme për zbatimin gjatë orës mësimore”, rezultatet e marra për pyetjet: “Në përgjithësi, a keni gatishmëri ta zbatoni kurrikulën në Shkencat e natyrës?”, dhe në pyetjen: “Kurrikula në Shkencat e natyrës, a është e përshtatshme për zbatim?” Përgjigjet e këtyre pyetjeve, na tregojnë se kemi korrelacion me lidhje të mesme prej r= .520*.Mësimdhënësit, të cilët mendojnë që kurrikula është e përshtatshme për zbatim, janë në gatishmëri ta zbatojnë kurrikulën, në të cilën niveli i signifikancës është .019 që është në nivelin e besueshmërisë prej .01, ku themi se statistikat kanë lidhje pozitive.

Vërtetimi i hipotezës II përmes korrelacionit “Mësimdhënësit janë të kënaqur me suksesin e kurrikulës në shkencat e natyrës”. Në bazë të rezultateve të mësipërme, shohim se kemi korrelacion pozitiv të mesëm prej r= .663** në mes të pyetjes se a janë optimistë në suksesin e kurrikulës në Shkencat e natyrës dhe të pyetjes:” Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës, a janë të arritshme nga nxënësit?” Mësimdhënësit që mendojnë se rezultatet e të nxënit janë të arritshme nga nxënësit, janë optimistë në suksesin e kurrikulës, në të cilat niveli i signifikancës është .01, ku themi se statistikisht kemi ndërlidhje positive signifikante =.001.

5.KONKLUDIME DHE REKOMANDIME

Rezultatet e fituara nga analizat e të dhënave dhe krahasimi i tyre me hipotezat e formuluara në fillim të hulumtimit për temën *Zbatimi i kurrikulës së Shkencave të natyrës në shkollat fillore në Vushtrri dhe në rajon*, na sjellin të dhëna të cilat kanë një rëndësi të madhe për hulumtimin që kemi bërë. Duke u bazuar në të dhënat e pranuara nga përgjigjet që kanë dhënë në pyetësor dhe nga literatura e shqyrtuar për realizimin e këtij hulumtimi, arrijmë në këto përfundime:

- Mësimdhënësit janë të informuar për mundësitë dhe kërkesat që gjenden në zbatimin e kurrikulës së Shkencave e natyrës.
- Kurrikula e shkencave të natyrës është e përshtatshme për zbatim në shkolla.
- Puna administrative rreth planifikimit të orëve mësimore sipas KKK-së ka ndryshuar. Nuk është e njëjtë siç ishte më herët.
- Trajnimet që kanë ndjekur nuk janë të mjaftueshme për të lehtësuar punën e mësimdhënësve në zbatimin e kurrikulës për shkencat e natyrës.
- Mësimdhënësit bashkëpunojnë njëri me tjetrin për t'i zgjidhur vështirësitë që shfaqen gjatë zbatimit të kurrikulës së shkencave të natyrës.
- Mësimdhënësit janë të gatshëm për zbatimin e kurrikulës së shkencave të natyrës

Edhe gjatë këtij hulumtimi kemi hasur vështirësi të ndryshme, sepse ishte koha e pandemisë dhe ishte vështirë per të mbledhur përgjigjet e pjesëmarrësve në mënyrë fizike. prandaj jam detyruar që të kontaktoj me mësues të shkollave për dorëzimin e pyetësorëve në mënyrë elektronike.

Duke u bazuar në të dhënat që kemi nxjerrë dhe nga literatuara e shqyrtuar për realizimin e këtij hulumtimi, kemi dhënë këto rekumandime:

- Të monitorohet zbatimi i kurrikulës për shkencat e natyrës nga MASHT-i.
- Të mbahen trajnime shtesë për mësimdhënësit për specifika të veçanta të kurrikulës së re.
- Të ofrohen sqarime më shumë rreth kurrikulës së shkencave të natyrës.
- T'u sqarohet nxënësve se si funksionon kurrikula dhe se ç'pritet saktësisht nga ata që të përmbushin.

LITERATURA

1. Alidemaj, F. (2019). *Teachers' Perceptions of the Curricular Reform Implementation in Kosovo.* Thesis. Vol. 8, No. 2. (137-162). file:///C:/Users/user/Doënloads/Fatjona_Alidemaj.pdf
2. Alimehmeti, M & Danglli, L. *Mesuesi shqiptar perball kerkesave te sotme per zhvill.prof.* University of Tirana, Albania.https://ëëë.academia.edu/8657246/Mig_artik_lituani_shqip_per_mozen
3. Beka, A. (2004). *Partial or comprebensiv reform in the curricula of elementary, grades 1-5, in Kosova.* http://dspace.epoka.edu.al/bitstream/handle/1/770/746-2171-1-PB.pdf?isAlloëed=y&sequence=1
4. Boshtrakaj,L&Rraci,E& Bajrami,K(2018,11). *Sfidat e zbatinit të reformës kurrikulare në arsimin parauniversitar në Kosovë.*Prishtinë.KEEN. https://keen-ks.net/site/assets/files/1444/sfidat_e_zbatimit_te_reformes_kurrikulare_alb-1.pdf
5. Hardman, J., & A-Rahman, N. (2014*). Teachers and the implementation of a neë English curriculum in Malaysia. Language,* Culture and Curriculum, 27(3), 260–277, DOI: 10.101080/07908318.2014.980826
6. Instituti Pedagogjik I Kosovës. (2016). *Udhëzues për udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në shkollë*. Prishtinë http://ipkmasht.rks-gov.net/ëp-content/uploads/2017/03/Udhezuesi-per-zbatim-te-kurrikules1.pdf
7. Ismajli,H& Keasniqi, D 2018.*Challendes for achieving learning outcomes of languages and communication curriculum area in primary education in Kosovo*. DOI: 10.31458/iejes.442458
8. Jessie S. Barrot (2018): *English Curriculum Reform in the Philippines: Issues and Challenges from a 21st Century Learning Perspective*, Journal of Language, Identity & Education, DOI: 10.1080/15348458.2018.1528547.
9. Mehmeti, S &Raci, E & Bajrami, K. (2019). *Zhvillimi professional I mësimdhënësve në Kosovë.* Instituti Pedagogjik i Kosovës. Prishtinë.

https://keen-ks.net/site/assets/files/1467/zhvillimi_profesional_i_mesimdhenesve_ne_kosove_alb-1.pdf

10. MASHT 2016. *Korniza Kurrikulare*. Prishtinë. https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/korniza-kurrikulare-finale.pdf
11. MASHT(2018). *Kurrikulat lëndore/programet mësimore Klasa e parë*. Prishtinë
12. MASHT 2018. *Kurrikulat lëndore/programet mësimore Klasa e dytë*. Prishtinë
13. MASHT 2018. *Kurrikulat lëndore/programet mësimore Klasa e tretë*. Prishtinë
14. MASHT 2016.*Kurrikula bërthamë*. Prishtinëhttps://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/kurrikula-berthame-1-finale-2.pdf
15. MASHTA 2011. *Korniza e kurrikulës e arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës*. Prishtinëhttps://edumedia depot.gei.de/bitstream/handle/11163/1238/776692704_2011_A.pdf?sequence=2
16. MASHT. (2003). *PLANI DHE PROGRAMI MËSIMOR Për klasën e parë fillore*. Prishtinë
17. MASHT. (2004). *PLANI DHE PROGRAMI MËSIMOR Për klasën e dytë fillore*. Prishtinë
18. Midak, L. et al. (2020). *Augmented reality technology within studying natural subjects in primary school.*Ukraine. http://lib.pnu.edu.ua:8080/bitstream/123456789/2602/1/paper18_%d0%a1%d1%82%d0%b0%d1%82%d1%82%d1%8f%21%21%21.pdf
19. Kastrati, R& Avdylaj, M. (2014). *Udhësues praktik për zbatimin e kurrikulës në shkencat e natyrës*. Instituti i Pedagogjik i Kosovës https://skencbiologjia.ëeebly.com/uploads/4/2/8/7/42875545/udhzuesi_i_fushs_kurrikulare_shkencat_e_natyrs.pdf?fbclid=IëAR3HgyGVyd5fmU_yrERh23SUIrMNzhJjZVx9nvX0hyUlnm1O_pRuRkBBë-I
20. Zeqiri, V.(2014).*Mapping of Education for Sustainable Development in the neë Curriculum of Kosovo and Challenges of Implementation Introduction*, Book 1, Vol. 1, 803-810 ppDOI: 10.5593/sgemsocial2014/B11/S3.103

SHTOJCAT

Pyetësori për hulumtim

Ky pyetësor do të përdoret për hulumtimin që jam duke e zhvilluar për finalizim të studimeve në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini" – Fakulteti i Edukimit. Përmes këtij hulumtimi kam për qëllim të pasqyroj zbatimin e Kurrikulës në Shkencat e natyrës në shkollat fillore (klasa 1-5) në qytetin e Vushtrrisë dhe fshatat në rrethinë. Do ta vlerësoja nëse do të pajtoheshit për t'u përgjigjur pyetjeve të këtij pytësori. Të gjitha përgjigjet e marra do të trajtohen si të dhëna grupore dhe do të përdoren vetëm për qellimet e këtij studimi. Unë garantoj anonimitetin dhe konfidencialitetin e të gjithë të anketuarve në këtë hulumtim.

Të dhënat e përgjithshme:

1. Gjinia:

- Mashkull
- Femër

2. Vendbanimi:

- Urban
- Rural

3. Niveli i arsimimi që e keni përfunduar:

- Shkolla normale
- Bachelor
- Master
- PhD

4. Mosha e juaj:

- >50
- 50

- <50

5. Përvoja e punës si mësimdhënës/se?

- 0-1 vit
- 1-5 vjet
- 6-10 vjet
- <11 vjet

6.Sa jeni të informuar për mundësitë dhe kërkesat të Kurrikulës në Shkencat e natyrës?

- Nuk pajtohem aspak
- Nuk pajtohem
- Nuk e di
- Pajtohem
- Pajtohem tërësisht

7. Kurrikula në Shkencat e natyrës është e përshtatshme për zbatim?

- Nuk pajtohem aspak
- Nuk pajtohem
- Nuk e di
- Pajtohem
- Pajtohem tërësisht

8. Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës janë të arritshme

nga nxënësit?

- Nuk pajtohem aspak
- Nuk pajtohem
- Nuk e di
- Pajtohem
- Pajtohem tërësisht

9. Puna administrative rreth planifikimin dhe përgatitjes së orës mësimore sipas

KKK-së, a ka ndryshuar?

- Nuk pajtohem aspak
- Nuk pajtohem
- Nuk e di
- Pajtohem
- Pajtohem tërësisht

10. Planifikimet ditore, a janë në harmoni me planet vjetore?

- Nuk pajtohem aspak
- Nuk pajtohem
- Nuk e di
- Pajtohem
- Pajtohem tërësisht

11. Udhëzuesit e KKK-së, a ju ndihmojnë në planifikimet tuaja?

- Nuk pajtohem aspak
- Nuk pajtohem
- Nuk e di
- Pajtohem
- Pajtohem tërësisht

12. Trajnimet që i keni ndjekur, a janë të mjaftueshme për zbatimin e kurrikulës në shkencat e natyrës?

- Nuk pajtohem aspak
- Nuk pajtohem
- Nuk e di
- Pajtohem
- Pajtohem tërësisht

13. Plani i përgatitur për orë mësimore, zbatohet gjatë orës nga ana juaj?

- Nuk pajtohem aspak
- Nuk pajtohem
- Nuk e di
- Pajtohem
- Pajtohem tërësisht

14. Bashkëpunoni me kolegët tuaj për t'i zgjidhur vështirësitë që dalin gjatë zbatimit të Kurrikulës në shkencat e natyrës?

- Nuk pajtohem aspak
- Nuk pajtohem
- Nuk e di
- Pajtohem
- Pajtohem tërësisht

15. Në përgjithësi, a keni gatishmëri ta zbatoni Kurrikulen në shkencat e natyrës?

- Nuk pajtohem aspak
- Nuk pajtohem

- Nuk e di
- Pajtohem
- Pajtohem tërësisht

16. Në përgjithësi, a jeni optimistë në suksesin e kurrikulës në Shkencat e natyrës?

- Nuk pajtohem aspak
- Nuk pajtohem
- Nuk e di
- Pajtohem
- Pajtohem tërësisht

AUTOBIOGRAFIA

Unë, Lendita Basholli, jam lindur me 11.10.1996 në Vushtrri. Shkollën fillore dhe të mesme të ulët, e kam përfunduar në SHFMU “Lumni Surdulli” në Samadrexhë, ndërsa shkollën e mesme të lartë e kam mbaruar në shkollën profesionale “Bahri Haxha”, në Vushtrri.

Studimet e larta i kam nisur në Fakultetin e Edukimit “Isa Boletini” -Programi Fillor, në Mitrovicë. Studimet i kam filluar nga viti 2016 dhe tash jam duke i përfunduar ato.